

volumi 4, numri 3  
verë 2006

Zëri i

# Gruas Kosovare

## KPG Pajtohen për Kosovën e Pavarur

Koalicioni kërkon përfshirjen e grave në të gjitha proceset vendim-marrëse

### Përmbajtja

- 2 Aktivistet Krijojnë Strategjinë për Monitorimin Rez. 1325
- 2 Qeveria e Kosovës Financon Strehimoret
- 2 Shënime nga takimi i Qershorit
- 3 Behar Selimi: Përkrahës i Barazisë Gjinore
- 3 Kodi i mirësjelljes Ngrit Kapacitetet e OJQ-ve
- 4 Medica Kosova Përkrahë Gratë Rurale
- 4 Gratë Lidere nga Evropa Juglindore Deklarojnë

### Njohtimet

Takimi i RRGK-së.....  
....ATRC, 11:00, 6 Nëntor

Vizitoni Web faqen  
tonë të RE!!!

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org)

**Falenderim Special**  
dizajneres:  
**Barbra Bearden,**  
praktikante nga  
**Advocacy Project**

RRJETI I GRUPEVE TË  
GRAVE TË KOSOVËS



[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org)

Java e kaluar shënoi një moment historik për proceset paqësore në Kosovë, Serbi dhe rajon.

Koalicioni Paqësor i Grave (KPG), i përbërë nga Rrjeti i Grupeve të Grave nga Kosova dhe Gratë në të Zeza nga Serbia, mbajtën një konferencë treditore në Strugë të Maqedonisë, me temën "Gratë, Paqja dhe Siguria", për të bërë më të dukshme punën e grave aktiviste në krijimin e një paqeje stabile dhe të drejtë për rajonin.

Në konferencë – e cila u mbajt në njëjtën kohë me negociatat zyrtare mes përfaqësuesve nga Beogradi dhe Prishtina mbi statusin final të Kosovës, 60 aktiviste nga Kosova dhe Serbia konkluduan, përmes një deklarate të përbashkët, se paqja në rajon nuk mund të arrihet pa pjesëmarrje aktive të grave. Ato përkrahën pavarësinë dhe integritetin territorial të Kosovës si shtet civil me sistem funksional ligjor, dhe kërkuan që:

1. Nevojat e të gjithë qytetarëve – femrave dhe meshkujve – të paraqesin bazën për paqe dhe siguri.
2. Institucionet relevante të adaptojnë një koncept të sigurisë njerëzore, posaçërisht

nga perspektiva gjinore, duke vepruar kështu në pajtim me Rezolutën 1325 të KS të OKB

3. Gratë të jenë të përfshira në të gjitha proceset vendimmarrëse në të gjitha nivelet.

Përkundër politikave zyrtare që sjellin përçarje dhe konflikt, KPG krijoi plane për të vazhduar ndërtimin e besimit, solidaritetit dhe përkrahjes së ndërsjellë mes grave, drejt krijimit të paqes së qëndrueshme në rajon. KPG krijoi planin njëvjeçar të veprimit që ka për qëllim të:

- Shtojë dialogun mes grave të të gjitha grupeve etnike nga Serbia dhe Kosova, përmes takimeve dhe diskutimeve lidhur me sigurinë e grupeve të ndjeshme, statusin përfundimtar të Kosovës dhe përfshirjen e shtuar të grave në vendimmarrje;

- Shtojë rrjetëzimin dhe volumin e veprimtarive të përbashkëta mes organizatave të udhëhequra nga gratë, që kanë misionet të ngjashme politike, nga Kosova dhe Serbia;

- Përkrah fuqizimin e të drejtave të grave, posaçërisht të drejtave reproduktive.

drejtave reproduktive.

Marrëveshja e arritur mes pjesëmarrësve tregon se si procesi negociator lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, ka humbur duke mos i dhënë grave aktiviste paqësore mundësinë që të jenë pjesë e tij.

Përveç kësaj, gjatë konferencës, përfaqësueset e Rrjetit të Grave në të Zeza nga Serbia, kërkuan falje për krimet dhe terrorin e kryer në emër të tyre nga regjimi Serb ndaj shqiptarëve të Kosovës. Kjo nxiti një reagim zinxhiror i cili shpuri tek kërkim-falja nga ana e Rrjetit të Grave në të Zeza publikisht në Radiotelevizionin e Kosovës. Kjo ishte deklarata e parë e tillë e dhënë publikisht. Aktivistet theksuar rëndësinë e apologjisë zyrtare në procesin e shërimit, si një parakusht të rëndësishëm për një paqe të qëndrueshme.

Rrjeti i Grave në të Zeza nga Serbia dhe Rrjeti i Grupeve të Grave nga Kosova, të përkrahura nga UNIFEM, lansuan Koalicionin Paqësor të Grave në maj të këtij viti, si iniciativë qytetare të themeluar në bazë të solidaritetit të grave, që tejkalon kufijtë, pengesat dhe ndasitë kombëtare, etnike dhe fetare. Dy takimet parapake të KPG, të mbajtura në Prishtinë dhe Beograd, kanë rezultuar me deklarata të përbashkëta.



Gratë aktiviste për paqe nga Kosova dhe Serbia përpilojnë strategji për paqe në rajon gjatë konferencës "Rezoluta 1325 e KSKB – Gratë, Paqja, Siguria".



Gratë nga Kosova dhe Serbia diskutojnë mbi statusin politik të Kosovës dhe sigurinë, gjatë konferencës në Strugë, me 1-2 Shtator.

## Shënime nga takimi i Qershorit

\* Organizata "Unë Gruaja" mbajti një konferencë rajonale në Pogradec të Shqipërisë, me temën "Barazia Gjimore në vendimmarrje." Gra nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia u rrjetëzuan dhe identifikuan mënyra për të ngritur numrin e posteve vendimmarrëse të mbajtura nga gratë, posaçërisht shkaku i zgjedhjeve lokale që kësaj vjeshte mbahen në Shqipëri. Përfaqësueset e RRGK propozuan idetë e tyre, duke u bazuar në përvojën e tyre nga Kosova.

\* Përfaqësuese të RRGK dhe Rrjetit të Grave në të Zeza nga Serbia formuan Koalicionin Paqësor të Grave në maj të vitit 2006. Deklarata e parë e Koalicionit, që iu dërgua qeverisë së Kosovës dhe Serbisë, mediave dhe vendimmarrësve tjerë, informonte biseduesit në negociatën të Vjenës lidhur me trashëgiminë kulturore. Edhe pse gratë nuk përfaqësohen në ekipin negociator, ato shprehën mendimet e veta lidhur me këtë çështje.

\* Me leje nga Ministria e Arsimit, Organizata Violete filloi mbajtjen e një seminari me temën "Si të parandalohet HIV – AIDS," që do të mbahet në 30 shkolla anembanë Kosovës.

\* Plani i veprimit 'Mbroy Viktimën, Parandalo Trafikimin' për qasje kundër trafikimin u miratua në maj të vitit 2006. Grupi punues përfshinë përfaqësues nga të gjitha ministrinë, MVPT dhe Qendrave për Mirëqenien e Grave. Ata vazhdimisht do të azhurnojnë RRGK mbi punën e grupit.

\* Në fund të vitit 2006, SHE ERA do të formojë "Oden e Artizanaljinjve." Të gjitha organizatat që merren me prodhimin e punëve të dorës mund ta kontaktojnë SHE ERA për informata të mëtejshme.

\* Forumi i Grave Lokale ka organizuar një ekskursion me 55 gra Shqiptare e Serbe në Brezovicë, ku ato kanë kaluar një ditë së bashku.

## Gratë nga Kosova dhe Bosnja Krijojnë Strategjinë për Monitorimin e Zbatimit të Rezolutës 1325

Përfaqësuesit e 'Zene Zenama' dhe Rrjetit të Grupeve të Grave nga Kosova u takuan në Sarajevë më 28-29 qershor për të krijuar një metodë të hulumtimit për monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325 së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë. Takimi u organizua me ndihmën e UNIFEM-it.

Punëtorja ishte vazhdimësi e hulumtimit preliminar mbi zbatimin e RKSOKB 1325, që u krye nga dy organizata gjatë vitit të kaluar. Pjesëmarrësit në punëtori shfrytëzuan informatat e marra gjatë vitit 2005 për të krijuar një metodë të monitorimit, në konsulta me ekspertët. Gjatë punëtorisë, ata shqyrtuan metodat gjithëpërfshirëse të hulumtimit dhe krijuan një kornizë të përbashkët të monitorimit. Ata identifikuan fushat vijuese si më relevante për zbatimin e RKSOKB 1325 në Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë:

- Gratë në vendimmarrje



*Përfaqësuesit e RRGK dhe Zene Zenama, me 28 – 29 korrik në Sarajevë, krijojnë strategji për implementimin e Rezolutës 1325 të KSKB.*

(posaçërisht pjesëmarrja e grave në ndryshimet kushtetuese dhe në negociatat për statusin final të Kosovës)

- Të drejtat njerëzore të grave (dhuna ndaj grave, përfshirë dhunën familjare, trafikimi me qenie njerëzore dhe gratë e dhunuara në luftë)

- Integrimi i perspektivës gjimore në sistemet kombëtare të

sigurisë.

- Integrimi i perspektivës gjimore në operacionet paqeruajtëse të OKB-së

- Raportimi nga Sekretari i Përhershëm tek Këshilli i Sigurimit lidhur me progresin e përmirësimit të rrjedhës së çështjeve gjimore në misionet paqeruajtëse (KSOKB 1325, neni 17)

## Qeveria e Kosovës Pajtohet të Financojë Strehimoret

Pas më se dy vite takimesh me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, strehimoret të grave në Kosovë u është premtuar financim qeveritar. Përderisa këto vendstrehime kanë ofruar shërbime për qeverinë që nga viti 2000, përfshirë edhe strehimin për viktimat e dhunës familjare dhe ndihmën ligjore, vetëm një numër i vogël i tyre kanë pranuar ndihmë financiare nga qeveria.

Strehimoret janë ballafaqur me një numër më të madh të rasteve që kanë mundur ta përballojnë, fizikisht apo financiarisht. "Ishte kjo një situatë e vështirë për ne," tha drejtoresha e vendstrehimit të Gjakovës Sakibe Doli. "Ne pranonim çdo ditë e më shumë kërkesa për ndihmë por donacionet zvogëloheshin nga dita në ditë."

Pasi që donatorët ndërkombëtarë janë duke u larguar nga Kosova, ndihma financiare nga

qeveria do të jetë thelbësore për të përmbajtur qëndrueshmërinë e strehimoreve. Një nga strehimoret që ka pranuar financime qeveritare ka qenë Strehimorja në Gjakovë, e cila ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në korrik të vitit 2006.

Për më se gjashtë vite, kjo strehimore ka ofruar shërbime thelbësore të cilat përfshinin, linjën telefonike SOS, strehim, përkrahje psikologjike dhe institucionale, ekzaminime mjekësore dhe mundësi për gratë që të avancojnë shkathësitë e tyre profesionale.

Ajo gjithashtu kujdeset për fëmijët që vuajnë nga dhuna familjare. Përveç këtyre shërbimeve, Strehimorja trajnon meshkujt nga institucionet që merren me çështje të dhunës familjare, në dhjetë komuna, përfshirë gjyqtarë, prokurorë, zyrtarë të Shërbimit Policor të Kosovës dhe avokatë mbrojtës.

Ajo gjithashtu ka shërbyer si qendër trajnimi për stafin e strehimoreve tjera në Kosovë. Sa i përket parandalimit, strehimorja trajnon të rinj dhe organizon fushata për të informuar popullatën mbi dhunën familjare. Në të kaluarën, strehimoret kanë pranuar ndihmë nga Fondi Kosovar për Shoqëri të Hapur, Christian Aid, Diakonia, dhe posaçërisht nga Caritas, të cilët paguan për ndërtesën e strehimores dhe vazhdojnë të sigurojnë ndihmë. Doli me kënaqësi përmendi edhe qeverinë si një nga përkrahësit. "Duke iu ndihmuar grave që kanë nevojë për këtë, qeveria i respekton të drejtat e tyre dhe promovon një shoqëri demokratike," tha ajo.

Përderisa të gjitha strehimoret kanë nënshkruar marrëveshje me ministrinë sa i përket pranimit të ndihmës financiare, kjo strehimore është e vetmja e llojit që ka pranuar fondet deri më sot.

## Behar Selimi: Përkrahës i Barazisë Gjinore

Zëvendës-komesari i Shërbimit Policor të Kosovës për Shtyllën e Administratës Behar Selimi është një nga avokuesit më të fuqishëm të Kosovës për arritjen e barazisë gjinore.

Ai ka përkrahur politikat drejt arritjes së barazisë gjinore në SHPK, ka promovuar gra në pozita më të larta brenda shërbimit, ka mbajtur trajnime lidhur me çështjet gjinore dhe ka avokuar për politika për arritjen e barazisë gjinore në rajon.

"Jam i bindur se barazia gjinore do të përkrahë krijimin e një shoqërie të zhvilluar dhe një lirie individuale", tha Selimi. Pas miratimit të Planit Kombëtar të Veprimit për arritjen e Barazisë Gjinore, Selimi u emërua koordinator për zbatimin e këtij plani brenda SHPK. Që atëherë Selimi ka udhëhequr përpjekjet për të miratuar një plan, i cili tenton të përfshijë çështjet gjinore në të gjitha strukturat dhe politikat qendrore të SHPK. "Barazia gjinore nuk është më për zyrtarët e SHPK-së vetëm një veprim i vullnetit të mirë," tha Selimi. "Tani kjo është e obligueshme dhe rregullohet me procedura përkatëse." Selimi ka punuar shumë për të arritur në këtë stad. Para emërimit të tij si Zëvendëskomesari i Shtyllës së Administratës së SHPK-së, Selimi i është dashur të kalojë nëpër gradat e SHPK-së.

Në të kaluarën kur kryente punën e policit të trafikut, zëdhënësit të SHPK-së apo komandantit të divizionit ai shpesh paraqiste vetëm një zë të vetëm të pakënaqur kur gratë lireshin jashtë proceseve vendimmarrëse. Selimi ndjente se gratë meritonin respekt për rolin e tyre në Kosovë para luftës: ato qëndruan pranë burrave të tyre, përkrahën familjet e tyre, morën



*Behar Selimi, Zëvendës-komesari i Shërbimit Policor të Kosovës për Shtyllën e Administratës, avokon fuqishëm për barazi gjinore.*

pjesë aktivisht në institucionet paralele dhe kontribuuan në arritjen e aspiratave lidhur me statusin politik të Kosovës.

Duke shërbyer në pozita më të ulëta në SHPK, Selimi kalonte javë të tëra duke tentuar të bindë mbikëqyrësit e tij lidhur me rëndësinë e sigurimit të mundësive për femra në SHPK. Avancimi i tij i mëpasme në pozita menaxhuese brenda SHPK-së i mundësoi Selimit që të kërkojë ndryshime edhe më të rëndësishme. "Tani unë mund t'i marrë vendimet vet", tha ai. "Kjo tregon se sa është e rëndësishme të kemi njerëz të vetëdijshëm mbi çështjet gjinore në pozita udhëheqëse." Përmes pozitës së tij, Selimi ka sjellë më shumë femra në pozitat menaxhuese të SHPK-së. Ai ka për cak që femrat dhe meshkujt të mbajnë së paku 40% të pozitave në SHPK, sipas kuotës së paraparë me

Ligjin për Barazinë Gjinore. A i gjithash-tu ka n d a r e buxhetin për projekte me

perspektivë gjinore.

Si trajnues i certifikuar për çështje gjinore, Selimi ka fuqizuar gratë në SHPK përmes trajnimeve dhe mundësive për zhvillimin e karrierës, si dhe ka edukuar zyrtarët e rinj policor mbi barazinë gjinore.

Si rrjedhojë e përkushtimit të tij për arritjen e barazisë gjinore dhe bashkëpunimit të tij me organizata joqeveritare të grave, në vitin 2004 anëtarët e RRGK dhe zgjedhën Selimin për të shërbyer si anëtar i Bordit të RRGK. "U ndjeva tejet i privilegjuar që të jem anëtar i bordit", tha ai. "Isha i vetmi mashkull dhe ndjehesha mirë për këtë. Tani ndihem edhe më mirë që kur më është bashkëngjitur edhe Besim Kajtazi." Ai ka marrë pjesë aktivisht në trajnimet dhe takimet vendore dhe ndërkombëtare të RRGK. Ai ka marrë pjesë rishitas si përfaqësues i RRGK në Sarajevë ku është takuar me zyrtarë tjerë policor.

Ai shfrytëzoi këtë mundësi për të theksuar rëndësinë e barazisë gjinore brenda trupave policore dhe për të avokuar për miratimin e politikave tjera për të arritur këtë në rajon. Puna e Selimit në barazinë gjinore në Kosovë ka përcaktuar një shembull pozitiv për zyrtarët policor anëmbanë botës.

### Kodi i mirësjelljes Ngrit Kapacitetet e Organizatave Kosovare për të ardhmen

Gjatë verës, organizatat anëtare të RRGK janë takuar për të diskutuar dhe nënshkruar Kodin e Etikës dhe Përgjegjive të RRGK.

Ky dokument do të përcaktojë standardet për përgjegjësi dhe transparencë për anëtarët e RRGK në të ardhmen. Kodi përfshinë gjashtë parime bazike: Misionin dhe Programin, Qeverisjen e Mirë, Burimet Njerëzore, Transparencën dhe Përgjegjësinë Financiare, Përgjegjësitë dhe Civile dhe Partneritetet dhe Rrjetëzimin. Anëtarët e RRGK do të përfshijnë këto parime në punën e tyre përmes një serie të standardeve gjatë tri viteve të ardhshme. Progresi i tyre do të monitorohet dhe vlerësohet çdo vit nga një Komision Vlerësues që do të përbëhet nga homologët e tyre dhe faktorë tjerë jo të ndërlidhur.

RRGK plotësisht mbështet zbatimin e këtij kodi. Gjatë periudhës trevjeçare, RRGK do të mbajë trajnime dhe punëtori dhe do të punësojë konsulentë nga jashtë për të ndihmuar të gjitha organizatat në zbatimin e parimeve të këtij kodi.

Më me rëndësi është se kodi do t'u ndihmojë anëtarëve në ngritjen e kapaciteteve si organizata, drejt arritjes së një të ardhme të qëndrueshme.

**"Është e rëndësishme që vendim-marrësit të jenë të vetëdijshëm për barazi gjinore"**  
- Behar Selimi

## Kosova Women's Network

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org)

[info@womensnetwork.org](mailto:info@womensnetwork.org)

Hajdar Dushi C-2, II/8

Prishtinë, Kosovë

## Stafi i RRGK

### Igalle Rogova

Drejtoresh Ekzekutive

[igo@womensnetwork.org](mailto:igo@womensnetwork.org)

### Besa Shehu

Menaxhere e Financave

[info@womensnetwork.org](mailto:info@womensnetwork.org)

### Nexhmije Fetahu

Menaxhere e Programit

[info@womensnetwork.org](mailto:info@womensnetwork.org)

### Alba Loxha

Marrëdhëniet me Publikun

[info@womensnetwork.org](mailto:info@womensnetwork.org)

### Barbra Bearden

Praktikante

nga Advocacy Project

## Bordi i RRGK

Naxhije Buçinca

Delina Fico

Besim Kajtazi

Marta Prekpalaj

Vjosa Dobruna

Belgjyzare Muharremi

Behar Selimi

"Zëri i Gruas Kosovare" është shkruar dhe dizajnuar nga Alba Loxha dhe Barbra Bearden, me ndihmën e Nicole Farnsworth.

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org)

# Medica Kosova Përkrahë Gratë Rurale

Fshatrat e komunave të Gjakovës dhe Deçanit janë të pasura me begati natyrore. Shumë gra që jetojnë atje kanë përvojë të gjatë në kultivimin e bletëve, blegtori dhe prodhim të perimeve. Sidoqoftë, gjatë luftës, një pjesë e madhe e infrastrukturës bujqësore është shkatërruar.

Edhe më kritik është fakti se shumë gra që jetojnë në këto komuna kanë humbur burrat dhe djemtë gjatë luftës. Ato u bënë kryefamiljare, përgjegjëse për gjenerimin e të hyrave dhe kujdesin për anëtarët e familjeve në mënyrë të pavarur. Njëkohësisht, ato përpiqeshin që të shërohen nga traumat dhe nga humbja që kanë përjetuar.

Medica Kosova, organizatë anëtare e RRGK nga Gjakova, ka specializuar në përkrahjen e grave përmes proceseve shëruese të pasluftës, që nga viti 1999. Fillimisht, Medica ka ofruar kujdes shëndetësor për gratë dhe fëmijët që jetonin në fshatrat ku klinikat publike nuk ishin në dispozicion apo nuk kishin resurse të mjaftueshme. Ambulanca mobile e organizatës udhëtonte nëpër fshatra, duke ofruar ekzaminime gjinekologjike dhe shërbime konsultative kundër traumave. Klinika e saj në Gjakovë ofronte kontrollime mjekësore, përfshirë edhe ekzaminimet ultrasonike të gjirit me qëllim të parandalimit të kancerit të gjirit.

Sidoqoftë, të punësuarit në Medica shpejt kuptuan se familjet nuk mund të ishin të



Medica Kosova ndihmon dhe fuqizon gratë rurale.

shëndosha pa zgjidhur problemet që lufta i kishte lënë pas. "Shëndeti nuk paraqet vetëm mungesën e sëmundjes, por gjithashtu mirëqenien e përgjithshme psiko-fizike dhe sociale," thotë Veprorë Shehu, Drejtoreshë Ekzekutive e Medica Kosova.

Rrjedhimisht, Medica u përfshi në sigurimin e mundësive që gratë të rikthejnë jetët e tyre. Medica i ka furnizuar ato me pajisje tjera bujqësore. Gratë filluan të prodhojnë grurë, misër, fasule, patate, qumësht, ushqim për bagëti dhe produkte të mjaltës.

Njëkohësisht, Medica ndihmoi gratë në krijimin e grupeve vetë-ndihmuese në të cilat ato mund të ndërlihen me gra tjera të cilat gjenden në gjendje të ngjashme. Medica u ka ofruar atyre trajnim në udhëheqje, menaxhim, të drejta

ligjore në pronë dhe trashëgimi, prodhim, mirëmbajtje të pajisjeve dhe financa.

Më pas, disa nga gratë kanë filluar të formojnë grupe të pavarura përkrahëse dhe shoqata grash. Në të ardhmen, ato mund të bashkëpunojnë me shoqata bujqësore në Kosovë dhe jashtë saj. Kur shoqatat e grave fermere nga Tiroli jugor në Itali dëgjuan për këto shoqata të reja, ato ndanë një fond për të këmbyer vizita me to.

Duke u ndihmuar grave në krijimin e grupeve lokale të përkrahjes, rifillimin e punës që bazohet në përvojat e tyre paraprake dhe në gjenerimin e të ardhurave për përmbushur nevojat e familjeve të tyre, Medica Kosova ka ndihmuar qindra familje rurale në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe në rindërtimin e jetëve të tyre.

## Gratë Lidere nga Evropa Juglindore Deklarojnë

Këtë vit gratë politikane dhe aktivistet e shoqërisë civile nga tërë Ballkani u bashkuan në përpjekje për avansimin e paqes dhe stabilitetit në Evropën Juglindore. Ky aktivitet përkrahet nga UNIFEM-i. Ato kanë kërkuar zbatimin e plotë të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që kërkon nga të gjitha palët që të sigurojnë përfundim të grave në të gjitha

nivelet e vendimmarrjes.

Lobi i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore është takuar dy herë dhe ka dhënë deklaratat për shtyp lidhur me çështjet ndërkombëtare dhe rajonale.

Anëtare të këtij Lobi janë gra nga Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Në deklaratat e tyre ato kërkuar një zgjidhje paqësore dhe të

kuptueshme të statusit të Kosovës përmes bisedimeve dhe dënuan dhunën në Lindjen e Mesme. Të dyja këto çështje janë të rëndësishme nga këndvështrimi i mbrojtjes së drejtave të gruas dhe avancimit të paqes. Për më shumë informata lidhur me bashkëpunimet rajonale apo për të gjetur deklaratat e përmendura në këtë artikull, vizitoni ueb-faqen tonë të RE: [www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org).